

**giz**

## Partnerë në projekt

GIZ – Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Germany  
Jens Adler (jens.adler@giz.de)  
www.giz.de

**WIP**

WIP – Wirtschaft und Infrastruktur GmbH & CO Planungs KG, Germany  
Dominik Rutz (Dominik.Rutz@wip-munich.de)  
www.wip-munich.de

**KEA**

KEA – Klimaschutz und Energieagentur Baden-Württemberg GmbH, Germany  
Konstanze Stein (konstanze.stein@kea-bw.de)  
www.kea-bw.de

**e**  
AUSTRIAN ENERGY AGENCY

AEA – Austrian Energy Agency, Austria  
Martin Höher (Martin.Hoehner@energyagency.at)  
www.energyagency.at

**REGEA**

REGEA – Regional Energy Agency of North-West Croatia, Croatia  
Martina Krizmanić (mkrizmanic@regea.org)  
www.regea.org

**SDEWES-SKOPJE**

SDEWES-Skopje – International Centre for Sustainable Development of Energy, Water and Environment Systems - Macedonian Section, Macedonia  
Nataša Markovska (sdwes.skopje@sdwes.org)  
www.sdwes.org

**GREEN ENERGY**

GEA – Green Energy Association, Romania  
Lajos Vajda (greenenergy55@gmail.com)  
www.greenenergycluster.ro

**GIS**

GIS – Slovenian Forestry Institute, Slovenia  
Nike Krajnc (nike.krajnc@gozdis.si)  
www.gozdis.si

**SKGO**

SKGO – Standing Conference of Towns and Municipalities, Serbia  
Miodrag Gluscevic (Miodrag.Gluscevic@skgo.org)  
www.skgo.org



**BioVill**

## Kontakte

BioVill – Maqedoni

Natasha Markovska  
Vasil Bozhikaliev


Qendra ndërkombëtare për sisteme ujore, mjedisore dhe energjetike – Seksioni i Maqedonisë (SDEWES-Skopje)

Posta elektronike: [sdwes.skopje@sdwes.org](mailto:sdwes.skopje@sdwes.org)  
[www.sdwes.org/macedonian\\_section.php](http://www.sdwes.org/macedonian_section.php)

Vizitoni veb faqen e projektit:  
[www.biovill.eu](http://www.biovill.eu)



Ky projekt ka fituar mjete nga Programi i Unionit Europian për hulumtime dhe inovacione Horizon 2020, me Kontratë për Grant N° 691661



**Fshatra bioenergjetike (BioVill) –  
Rritja e depërtimit të bioenergjisë së  
qëndrueshme në treg**

Shtypi: Qendra ndërkombëtare për sisteme ujore, mjedisore dhe energjetike – Seksioni i Maqedonisë (SDEWES-Skopje) Republika e Maqedonisë, Gusht 2016



# BioVill

## Për proektin BioVill

BioVill është projekt trevjeçar i përkrahur nga Programi i Unionit Europian për hulumtime dhe inovacione Horizon 2020. Projekti ka filluar në Mars të vitit 2016 dhe i njëjti në bashkëpunim po implementohet ndërmjet nëntë partnerëve nga shtatë vende.

**Sfida:** Numër shumë i madh I vendeve të Europës Juglindore kanë potenciale shumë të larta të biomasës, por ato shpeshherë nuk janë (mjafatueshëm) të shfrytëzuara për furnizim lokal me energji dhe zhvillim ekonomik rajonal.

**Qëllimi:** BioVill përkrah konceptet regjionale për bioenergji, si dhe themelimin e fshatrave bioenergjetike në Maqedoni, Rumani, Slloveni, Serbi dhe Kroaci, nëpërmjet bartjes së përvojave egzistuese nga Austria, Gjermania dhe vendeve të tjera europiane tek partnerët në Europën Juglindore.

### Aktivitete kryesore:

- analizë e kushteve lokale dhe nacionale
- vlerësim të opsioneve teknologjike dhe ekonomike për themelimin e zinxhirëve lokal për bioenergji
- zhvillim të konceptit të etablimit institucional si dhe koncepteve për menaxhim të energjisë në fshatrat potenciale bioenergjetike
- trajnim të kuadrit dhe përfitim i njohurive praktike për skema financiare dhe biznes modele
- implementim të qasjes që përfshin numër të madh të aktorëve dhe që nënkupton pjesëmarrje aktive të qytetarëve dhe aktorëve tjerë në procesin e planifikimit dhe realizimit .

**Rezultate:** BioVill do të iniciojë së paku pesë fshatra bioenergjetike në vendet e përfshira – partnere, deri në fazën e investimit në infrastrukturë fizike, me çka do të kontribuojë në rritjen e depërtimit të bioenergjisë së qëndrueshme në treg.



## Fshatra bioenergjetike të ardhshme

**Perušić (1) dhe Lekenik (2) në Kroaci**

Perušić ka një potencial të lartë të biomasës dhe në komunë egzistojnë industri të drurit. Një ndërmarrje veçmë është angazhuar në prodhimin e peletave dhe ka ambicie për të ndërtuar termocentral që do të punojë me biomasë. Gjithashtu, Komuna Lekenik me resurset e veta të biomasës dhe interesit për instalim të termocentralit me biomasë për institucionet egzistuese publike posedon kushte fillestare të mira për të krijuar fshat bioenergjetik.

**Kërçova (3) në Maqedoni**

Komuna e Kërçovës ka potenciale të larta të biomasës siç janë biomasa pyjore, mbetjet nga blegtoaria, mbeturinat e ngurta si dhe mbeturinat nga përpunimi i drurit.

Lajtmotivet për tu përfshirë në projektin BioVill janë sigurimi i prodhimit të energjisë së pastër dhe kursim të energjisë

**Estelnic (4) dhe Ghelinqa (5) në Rumani**

Komuna Estelnic ka potencial të madh të biomasës dhe veç më egzistojnë instalime bioenergjetike. Qëllimi i pjesëmarrjes në projektin BioVill është përforcimi i komunitetit lokal dhe zhvillimi i një sistemi të qëndrueshëm energjetik. Edhe pse Ghelinqa e ka të zhvilluar mirë industrinë e drurit, infrastruktura për të shfrytëzuar nusproduktet ende nuk është e zhvilluar. Me pjesëmarrjen në projekt, komuna planifikon që të inkorporojë një zinxhir për furnizim me energji elektrike duke shfrytëzuar resurset lokale

**Kostojević (6) në Serbi**

Kostojević është e rrethuar me sipërfaqe malore pyjore. Por, sistemi lokal i ngrohjes në fshat ende bazohet në naftën e ngurtë. Shfrytëzimi i resurseve të qasshme drurore dhe ndryshimi i sistemit lokal të ngrohjes nga nafta në biomasë është motivimi kryesor i fshatit për të marrë pjesë në projekt.

**Dole pri Litiji (7) në Slloveni**

Komuniteti Dole pri Litiji tradicionalisht është i lidhur me drurin si resurs. Në të egziston industria e drurit, siç janë fabrikat e sharrave. Ato, duke marrë parasysh edhe faktin që deri tani objektet janë ngrohur individualisht, paraqesin një bazë të mirë për tu shndërruar në fshat bioenergjetik

## Çka është fshati bioenergjetik?

Fshati bioenergjetik është lagje, fshat, komunë ose komunitet (ose diçka nga ato) i cili nevojat e veta për energji (energji elektrike dhe nxehtësi) i plotëson nëpërmjet biomasës lokale, si dhe nëpërmjet burimeve të tjera të energjisë së rinovueshme

Faktorët kyç për sukses të një fshati bioenergjetik

- **Qëndrueshmëri:** Biomasa prodhohet lokalisht dhe në mënyrë të qëndrueshme.
- **Plotësim të nevojave vetanake për energji:** Pjesa më e madhe e nevojës për energji (energji elektrike dhe nxehtësi) mbulohet me biomasë të prodhuar lokalisht ose me disa burime tjera të rinovueshme të energjisë.
- **Pronësi lokale:** Biznes-modeli iu lejon konsumatorëve, farmerëve dhe pronarëve të pyjeve të bëhen edhe pronarë të përbashkët të instalimeve bioenergjetike.
- **Zhvillim rajonal:** Përfitimet nga konceptet e këtylla mbesin në fshat, duke përkrahur zhvillimin ekonomik lokal dhe regjional.
- **Pjesëmarrja e publikut:** Krijimi dhe menaxhimi i fshatit bioenergjetik bazohet në shkallën e lartë të pjesëmarrjes së publikut.
- **Shfrytëzim efikas të resurseve:** Koncepti i fshatit bioenergjetik gjithashtu përfshin edhe masa për efikasitet energjetik dhe kursim të energjisë.